

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në ditët e fundit të afatit, ish-marinsi amerikan kërkon vëllanë në një kamp refugjatësh afganë në Katar
ADRESA	https://dosja.al/bota/ne-ditet-e-fundit-te-afatit-ish-marinsi-amerikan-kerkon-vellane-ne-nje-kamp-i516637
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 07:58:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 07:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2dfef58e963a5802c9a8484c052d4f89ae9974bf5406a987f1d42789f4203287
TEKSTI	bf6ace00e471de617e48a0ade049e5684272ac68da9482c4260d12fc19fce5ec
PAMJA	8e971bcbfab2e5500b9e7d56374ac5447f8f7e44d3f561a81851e5571ce5c287b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5420f144e1ca2a48d16b2fa07bf51fe997fdb34180c719dd97a56382537a231
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5420f144e1ca2a48d16b2fa07bf51fe997fdb34180c719dd97a56382537a231>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

13 ORE ME PARE

121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/
Protestuesit mesazh kryeministrit me
pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por
SPAK-u ka për ta mbledhur

14 ORE ME PARE

Debate për territorialen te "Ligjet"/
Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e
draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e
kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

19 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e
gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e
Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë
punën për ligjin e pagave

22 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder
tregon detyrat: Kapitujt duhen
mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në
balltë, do jetë dështim

Bota

Në ditët e fundit të afatit, ish-marinsi amerikan kërkon vëllanë në një kamp refugjatësh afganë në Katar

Vëllai i tij, ish-marinsi amerikan Sean Jamshidi, së voni shkoi në Katar, ku Masood po mbahet në një kamp së bashku me afër 1.100 afganë të tjerë. Për çudi të Seanit, atij iu ndalua qasja dhe ai kaloi disa ditë duke tentuar me dëshpërim që të gjente dikë që ta linte të hynte.

dosja

29 Shtator 2026, 09:50
Nga E. D

KATAR- Mohammad Masood Jamshidi ishte pjesëtar i sigurimit në Konsullatën amerikane në Herat kur ajo u sulmua me bomba nga talibanët. Ai shpresonte të merrte azil në Shtetet e Bashkuara, por tani frikësohet se do të dëbohet në Republikën Demokratike të Kongos.

Vëllai i tij, ish-marinsi amerikan Sean Jamshidi, së voni shkoi në Katar, ku Masood po mbahet në një kamp së bashku me afër 1.100 afganë të tjerë. Për çudi të Seanit, atij iu ndalua qasja dhe ai kaloi disa ditë duke tentuar me dëshpërim që të gjente dikë që ta linte të hynte.

Kampi As-Sayliyah, një ish-bazë e ushtrisë amerikane, pritet të mbyllet më 30 shtator, ndërsa banorët e tij ende nuk e dinë se çfarë do të ndodhë më pas.

"Ata janë të traumatizuar nga kjo situatë dhe dua të vij t'i takoj dhe t'u sjell pak para", tha Sean për Radion Evropa e Lirë më 23 shtator, duke iu referuar familjes së vëllait të tij.

"Nuk e dimë se ku mund të zhvendosen. Ata vazhdojnë të flasin për një shtet të tretë që nuk është Shtetet e Bashkuara, ndoshta në Afrikë, si Republika Demokratike e Kongos... Kur erdha këtu, më thanë se më ishte refuzuar leja për të hyrë në kamp", tha Sean.

Gjatë një udhëtimi të mëparshëm, në shkurt, atij i ishte dhënë leje për të hyrë në kamp.

Duke luftuar për lirinë

Shumë prej afganëve në kamp kanë punuar për forcat amerikane gjatë pranisë ushtarake ndërkombëtare të udhëhequr nga SHBA-ja në Afganistan, nga viti 2001 deri më 2021. Pjesa tjetër janë kryesisht familjarë të tyre. Pasi u evakuuan nga vendi pas tërheqjes së forcave amerikane dhe ndërkombëtare në vitin 2021, ata prisnin të

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një
konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

BOTA 29 SHTATOR 2026, 09:50

Në ditët e fundit të afatit, ish-
marinsi amerikan kërkon
vëllanë në një kamp
refugjatësh afganë në Katar

AKTUALITET 29 SHTATOR 2026, 07:51

Eksperti i sigurisë kibernetike:
Hakerat e "Homeland Justice"
publikojnë numrat e agentëve
të SHISH

Por, të gjitha kërkesat për imigracion lidhur me Afganistanin u pezulluan me një urdhër ekzekutiv presidencial në nëntor të vitit 2025, pasi një shtetas afgan qëlloi dy pjesëtarë të Gardës Kombëtare, njëri prej të cilëve vdiq një ditë pas të shtënave pranë Shtëpisë së Bardhë në Uashington.

Një zyrtar i Departamentit amerikan të Shtetit i tha REL-it se Shtetet e Bashkuara “e kanë mbajtur premtimin ndaj afganëve që rrezikuan jetën e tyre për të mbështetur Qeverinë amerikane gjatë përpjekjeve tona për t’i ndihmuar afganët të ndërtonin një vend më të mirë për veten”, duke shtuar se rreth 400.000 afganë janë zhvendosur në vende të reja që nga viti 2001.

“Departamenti i Shtetit vazhdon të punojë për një zgjidhje pozitive që u mundëson këtyre njerëzve që kanë mbetur të jenë të sigurt dhe të nisin një jetë të re jashtë Afganistanit, duke ruajtur njëkohësisht sigurinë e popullit amerikan”, tha zyrtari.

Megjithatë, zyrtari i DASH-it tha se “ka kaluar koha për t’i dhënë fund këtij konflikti që zgjat prej dekadash dhe për të parë drejt së ardhmes”.

Sipas AfghanEvac, një organizatë bamirësie që ka ndihmuar afganët e zhvendosur në vende të reja, të cilët ndihmuan përpjekjet e SHBA-së në Afganistan, 292 banorëve të kampit u është refuzuar zyrtarisht hyrja në SHBA. Organizata shtoi se më shumë se 400 banorë të kampit janë fëmijë.

Sean ka lindur në Afganistan dhe shkoi në SHBA në moshën 4-vjeçare, në vitin 2000. Ai u regjistrua në Trupat e Marinës amerikane kur mbushi 18 vjeç.

“Pashë marinsat në Afganistan dhe thashë: ‘E dini çfarë? Dua të bëhem marins, të ngrihem për atë që është e drejtë dhe të luftoj për liritë, liritë që i kemi në Amerikë”, tha ai.

Gjatë shërbimit 10-vjeçar, Sean shërbeu si komandant i sigurisë në Ambasadën amerikane në Republikën Demokratike të Kongos dhe gjithashtu u angazhua në kujdesin për afganët e evakuuar që mbërritën në Shtetet e Bashkuara në vitin 2021.

Ai tha se vëllai i tij, Masood, 49 vjeç, punonte si oficer sigurie për një kontraktor privat në Konsullatën amerikane në Herat, në Afganistanin perëndimor, ku mbronte personelin qeveritar dhe diplomatik.

Një fotografi e vitit 2013 shfaq Masoodin me ambasadorin e atëhershëm amerikan, James Cunningham. Në fotografi shihet edhe vula e SHBA-së, e dëmtuar gjatë një sulmi me makinë-bombë ndaj Konsullatës, ku në shtator të atij viti u vranë tetë roje afgane.

“Frika dhe humbja do t’i kishin penguar shumicën e njerëzve të ktheheshin, por zoti Jamshidy tregoi guximin dhe përkushtimin e tij duke u kthyer disa javë më vonë”, shkroi mbikëqyrësi i tij në një letër, me të cilën në dhjetor të atij viti rekomandoi që atij t’i jepej viza për të hyrë në SHBA.

Masoodi ka dy vjet që ndodhet në kampin As-Sayliyah, së bashku me gruan, tre fëmijët, dhëndrin dhe nipin trevjeçar.

“Ai rrezikoi jetën e tij. Prandaj është padyshim e trishtueshme që po flasin për një shtet të tretë, kur një person si ai rrezikoi jetën për politikën tona, për vlerat tona kulturore, për lirinë tonë”, tha Sean.

“Mirë se vini në SHBA”

Çështja e fatit të njerëzve në kamp është ngritur edhe në seancat dëgjimore në Kongres.

Në qershor, senatori demokrat Chris Coons nga Delaueri tha se në mesin e tyre ishin “400 fëmijë dhe 150 familjarë të pjesëtarëve të forcave aktive amerikane që aktualisht shërbejnë”.

Duke iu përgjigjur, sekretari i Shtetit, Marco Rubio, iu referua urdhrit ekzekutiv, por tha se Uashingtoni kishte biseduar me “disa vende” për t’u dhënë afganëve strehim. Ai tha se dëshironte që ata të gjenin “vendet e duhura ku të shkonin”.

Zyrtari i Departamentit të Shtetit që foli për Radion Evropë e Lirë e cilësoi As-Sayliyah si “trashëgimi të përpjekjes së administratës [të ish-presidentit demokrat amerikan, Joe] Biden për të zhvendosur sa më shumë afganë në Amerikë, pa i verifikuar siç duhet”.

Nuk raportohet se kushtet fizike në kamp përbëjnë problem. Por, njerëzit atje i kanë thënë Radios Azadi se janë të zemeruar nga qëndrimi për kaq gjatë në një gjendje pasigurie dhe nga ngarkesa emocionale që shkakton pasiguria për të ardhmen, teksa afrohet afati i 30 shtatorit për mbylljen e kampit.

VIDEO/ Personi më i moshuar i botës banon në Shqipëri, nënë Marra ka lindur 117 vjet e 39 ditë më parë

më të klikuarat

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet kandidatë

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow.

"Çdo njeri këtu në kamp është në ankth. Të gjithë po pyesim veten se çfarë do të ndodhë me ne dhe cili do të jetë fati ynë", tha një prej banorëve të kampit, i cili nuk pranoi të identifikohej.

"Ne nuk mund t'u besojmë këtyre njerëzve. A do të na çojnë në Amerikë, apo do të na dërgojnë në një shtet tjetër, ndoshta diku në Afrikë?", vazhdoi ai.

Ky person tha se familja e tij ishte ndarë nga kaosi i luftës dhe politikës ndërkombëtare që nga rrimarja e Kabulit nga talibanët në vitin 2021. Dy nga fëmijët e tij, tha ai, ndodhen në SHBA, një vajzë e ka në Iran, ndërsa dy fëmijë të tjerë në Afganistan.

"Ata na telefonojnë vazhdimisht dhe pyesin se çfarë po ndodh. Ata jetojnë të fshehur në një shtëpi në Kabul. Vetëm ky fakt është një burim i madh shqetësimi. Pastaj është edhe situata jonë këtu. Ne shpesh gjithçka që kishim, shtëpinë, gjërat tona dhe gjithçka tjetër... sepse besuam se do të shkonim në Amerikë", tha ky burrë.

Një burrë që zgjodhi të identifikohej vetëm me emrin e tij të parë, Faraidoon, 42 vjeç, tha se autoritetet e kampit zhvillonin takime të rregullta me banorët, por "në çdo takim thonë se nuk ka asnjë informacion".

Faraidooni ka rreth "dy vjet" që ndodhet në kamp, së bashku me gruan dhe tre fëmijët.

"Kur mbërritëm, madje kishte edhe një tabelë brenda kampit ku shkruhej: 'Mirë se vini në SHBA. Tani thjesht na kanë izoluar dhe nuk e kuptojmë se çfarë po ndodh', tha ai.

"Dje patëm një takim me drejtuesin e kampit dhe zyrtarë të tjerë. Bëmë shumë pyetje, por asgjë nuk është e qartë. Na thanë se ende nuk kanë marrë ndonjë urdhër që thotë se kampi do të mbyllet në atë datë. Po ashtu, askush nuk na ka thënë asgjë për një shtet të tretë", tha më 23 shtator një banor 65-vjeçar i kampit.

Rrëfime të tilla janë tipike për njerëzit në kampin As-Sayliyah.

Zyrtari i DASH-it i tha Radios Evropa e Lirë se autoritetet amerikane janë në "komunikim të rregullt dhe të drejtpërdrejtë me banorët për përpjekjet për sistemimin e tyre", duke thënë se "vazhdojnë të punojnë për të identifikuar mundësi për zhvendosjen vullnetare të të gjithë banorëve të kampit As-Sayliyah".

"Vendet e tjera nuk kanë asnjë detyrim ndaj këtyre njerëzve dhe ata nuk kanë lidhje me vende të tjera përveç Afganistanit, ku nuk është e sigurt që ata të shkojnë për shkak të marrëdhënies së tyre me Qeverinë e SHBA-së. Pra, këta njerëz janë vërtet mes dy alternativave të këqija", i tha Radios Evropa e Lirë Shawn VanDiver, një ish-ushtar amerikan, i cili si drejtues i AfghanEvac po bën fushatë që afganët të dërgohen në SHBA.

Sean Jamshidi, ish-marinsi amerikan, tha se pasojat për familjen e tij kanë qenë të mëdha.

"E humbëm babanë tonë në Amerikë teksa vëllai im ishte në kamp... [Vëllai im] nuk mundi të ishte aty për varrimin", tha ai duke shtuar se nëna e tyre ka pësuar dy sulme në tru gjatë dy vjetëve të fundit.

"Ka qenë shumë e vështirë për familjen tonë që nuk jemi në gjendje ta shohim njëri-tjetrin", u shpreh ai.

"Shpresoj që të dërgohen diku ku janë të sigurt, jo thjesht të dërgohen në një shtet tjetër të tretë që ka problemet e veta. Dhe, unë do të vazhdoj të luftoj për këtë gjë"./REL

Sondazh

Poll

Bota

29 Shtator 2026, 09:09

"Evropa të ruhet nga iluzioni i riarmatimit", Papa Leone XIV: Guxim në negociata dhe të sakrifikojë për paqen

Papa Leoni FRANCË- Në ditën e fundit të vizitës së tij katërditore në Francë, Papa Leoni XIV, në fjalimi...

Gjigandët e IA takohen sot me Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, çfarë pritet të diskutohet

Bota

29 Shtator 2026, 08:39

Pas dështimit të shitjes, BioNTech mbyll fabrikat e vaksinave në Gjermani, kompania përballet me humbje dhe padi

Bota

29 Shtator 2026, 08:29

18 miliardë dollarë investim/ Trump njofton ndërtimin e fabrikës gjigante të çelikut në Iowa: Më e madhe e në historinë e SHBA-së

Bota

29 Shtator 2026, 08:09

Blegtorët i drejtohet qeverisë me 7 kërkesa, nga heqja e akcizës të nafta te rialokimi i fondeve

Bota

29 Shtator 2026, 08:03

Bota

29 Shtator 2026, 07:28

Ushqimet mbajnë gjallë industrinë, nafta dhe kromi në rënie gjatë 2025

foto ilustruese TIRANË- Industria shqiptare shënoi rritje në prodhimin e disa prej produkteve kryesore gjatë vitit 2025, por rezul...

Netanyahu viziton Emiratet, Abu Dhabi konfirmon takimin me presidentin al-Nahyan

Bota

28 Shtator 2026, 22:58

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.